

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORCE

Nr.Regj.Them.514 Regj

Data e ardhjes 15.11.2014



Nr.vendimi 514 Regj.

Dt.vendimi 17.11.2014

**VENDIM**  
**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korçe, e perbere prej:

**MILIANA MUÇA** - Gjyqtare e vetme

asistuar nga sekretare seance gjyqesore Lorena Sadikllari, ne Korçe, sot me dt. 17.11.2014 ora 15.00, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura materialin procedues me nr. 514 regj. data e ardhjes 15.11.2014 qe iu perket:

**KERKUES:** Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe, e perfaqesuar ne gjykim nga prokurorja Dhorina Theodhori.

**KUNDER:** Ermal Pino, i biri i Apostolit, dt. 1987, banues ne Drenove, Korçe, me shtetesi shqiptare.

**IDYSHUAR:** Per kryerjen e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

**OBJEKTI:** Vendosja e mases e sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi llogarite bankare te shtetasit Ermal Pino prane Bankes se Pare te Investimeve Albania Sh.A.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 274 - 276 te K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi kerkesen e prokurorise dhe konkluzionet perfundimtare, ku u kerkua caktimi ndaj shtetasit Ermal Pino si mase sigurimi pasuror ajo e sekuestros preventive,

**VEREN:**

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe i ka paraqitur kesaj gjykate me date 15.11.2014 kerkesen per gjykim me objekt: *“Vendosjen e mases e sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi llogarite bankare te shtetasit Ermal Pino prane Bankes se Pare te Investimeve Albania ( First Investment Bank ) Sh.A*

Gjate shqyrtimit te kesaj kerkese rezultoi se:

“Ne prokurorine prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe eshte regjistruar procedimi penal nr.1499/viti 2014, mbi bazen e materialit hetimor te derguar nga ana e Drejtorise se Policise se qarkut Korçe, per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, *“pastrimi i produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale”*.

Rezulton se Drejtoria e Krimit Ekonomike Financiar Tirane ka informuar se me date 26.09.2014 prane Bankes se Pare te Investimeve eshte celur nje llogari bankare nga shtetasi Ermal Pino, llogari me numer AL0921541069 EUR1 000008057900.

Me date 27.10.2014 ne kete llogari ka nje transferte hyrese me urdherues Fung Thomas, nga Hong Kong Kine ne shumen prej 35000 eurosh, pa u pershkruar arsyeja dhe qellimi i kesaj dergese.

Shtetasi Ermal Pine eshte njoftuar nga banka me date 28.10.2014 per kete transferte dhe ai eshte paraqitur prane bankes me date 03.11.2014. Ka deklaruar se me shtetasin dergues te kesaj vlere kishte njohje personale dhe se i jane derguar per te blere nje pasuri. Ka deklaruar se kishte dhe nje prokure prej tij, por ate do ta dergonte ne banke ne vijim. Nga punonjesit e bankes i eshte thene se shuma do te qendronte pezull deri ne momentin e paraqitjes se prokures.

Pas kesaj, me date 10.11.2014 shtetasi Ermal Pino eshte riparaqitur ne banke dhe eshte shprehur se prokuren nuk e kishte ne formen e duhur.

Nga ana e organit te akuzes eshte hetur rreth ketyre momenteve:

- Nga te dhenat e sistemit TIMS se shtetasi Ermal Pine ne harkun kohor 2010 – 2014 ka disa hyrje - dalje ne shtetin Grek nepermjet pikes se kalimit kufitar Kapshtice;
- Shtetasi Fung Thomas nuk rezulton me asnje dalje hyrje - dalje ne territorin e Republikes se Shqiperise;
- Shtetasja Dhurata Pino ne vitin 2007 ka regjistruar ne fshatin Drenove – Korce nje aktivitet “ tregti me pakice “.

Duke patur parasysh keto rrethana:

- Faktin qe nga data e mberritjes se dergeses 27.10.2014 deri me date 07.11.2014 shtetasi Ermal Pine nuk ka treguar asnje interes per kete dergese, nderkohe qe ka celur nje llogari bankare vetem nje dite me pare;
- Faktin qe pretendon te kete nje prokure dhe kete prokure nuk e ka derguar ne institucionin bankar dhe pas paraqitjes per here te dyte;
- Faktin qe ai rezulton te jete i papune;

Duke i pare ne teresi keto rrethana kane lindur dyshime per aktivitetin e kryer prej tij, pasuar kjo me regjistrimin e procedimit penal.

Ne keto kushte, me qellim per te garantuar ecurine e metejshme te hetimeve, ne rrethanat e parashtruara me siper, prokuroria ka paraqitur kerkesen objekt gjykimi per te vendosur masen e sigurimit te sekuestros preventive mbi llogarine bankare te shtetasit Ermal Pino, llogari e hapur prej tij ne Banken e Pare te Investimeve, duke argumentuar se disponimi i lire i kesaj llogarie mund te vijoje zgjatjen e pasojave te vepres penale te dyshuar, objekt i procedimit penal te regjistruar.

Ne seance gjyqesore perfaqesuesja e prokurorise deklaroi shuma prej 35.000 eurosh eshte e bllokuar perkohesisht, pra nuk rezulton te jete e kaluar ne llogarine bankare te shtetasit Ermal Pino, duke argumentuar se mungesa e nje vendimi gjyqesor per vendosjen e mases se sigurimit te kerkuar ( *sekuestro preventive* ) do te lejonte qarkullimin e lire te kesaj shume.

ndhur me kërkesen e prokurorise per caktimin si mase sigurimi ate te "sekuestros preventive" te parashikuar nga neni 274 i Kodit te Procedures Penale gjykata cmon se ajo duhet te pranohet, sepse ekzistojne kushtet per caktimin e nje mase sigurimi me karakter pasuror. Konkretisht:

**Se pari:** Konstatohet nje rrezik real per kryerjen e veprimeve apo transaksioneve te tjera nga ana e shtetasit Ermal Pino, te tilla qe krijojne dyshim te arsyeshem se disponimi i lire i llogarise se tij bankare do te rendonte apo do te zgjaste pasojat e vepres penale per te cilen ai dyshohet, objekt i ketij procedimi.

**Se dyti:** Gjykata vlereson se vendosja e mases se sigurimit te kerkuar nga ana prokurorise eshte jo vetem me karakter te ngutshem, por edhe justifikuar dhe e provuar ne rrethanat konkrete te ceshtjes.

Per kete mbahet parasysh nga koha e shkurter e veprimeve, dmth diferenca e shkurter kohore nga hapja e llogarise dhe kalimi i shumes prej 35000 euro, e pare kjo ne lidhje me deklarimin e pavertete te tij para punonjesve te bankes per ekzistencen e nje prokure nga shtetasi kinez Fung Thomas, rrethana keto te tilla qe e bejne te besueshem dyshimin per nje veper penale konkrete, ne fushen financiare.

Sa me lart, gjykata cmon si te pershtatshme masen e sigurimit me karakter pasuror ( neni 274 i K.Pr.Penale ) te kerkuar nga ana e prokurorise dhe si e tille kërkesa duhet te pranohet.

### PER KETO ARSYE,

Gjykata mbeshtetur ne nenet 244 – 245, 274 te K.Pr.Penale,

### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkeses se Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korce, duke vendosur mases e sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi llogarine bankare te Ermal Postol Pino prane Bankes se Pare te Investimeve – Albanaia Sh.A, nr. AL0921541069 EUR1 000008057900.
2. Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.
3. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Korce brenda 10 diteve duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes se vendimit.

Per personat e interesuar, ky afat fillon nga e nesermja e marrjes per dijeni per vendimin.

U shpall ne Korce sot me dt. 17.11.2014 ora 15.5

SEKRETARE  
LORENA SADIKLLARI



GJYQTARE  
MILIANA MUÇA

